



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2426/ 13 prot.

Datë 29.10.2024

V E N D I M

Nr. 1515/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 29.10.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDERTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk, për procedurën e prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me Nr. REF-10941-06-24-2024, me objekt “Kontrata punimesh dhe Mirëmbajtje të rrugëve nacionale (kontratat e mirëmbajtjes), Rajoni Verior Shkodër” (ndarë në 15 lote), Fondi limit i përgjithshëm / vlera e pritshme e kontratës: 2,966,127,447 (dy miliard e nëntëqind e gjashtëdhjetë gjashtë milion e njëqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e dyzet e shtatë) Lekë pa TVSH. Në Euro: 29,584,355.14 (njëzet e nëntë milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë pikë katërmëdhjetë) Euro pa TVSH, Numri i referencës së **Lotit 1: REF-10943-06-24-2024 me objekt: “Loti 1: Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km), me vlerë totale 319,256,430 (treqind e**

nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tridhjetë) **Lekë pa TVSH. Në Euro: 3,184,285.16** (tre milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë pikë gjashtëmbëdhjetë) **Euro pa TVSH**, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga BOE “Varaku E & Ndertuesi 2014” SHPK në procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-10943-06-24-2024, me objekt: “Loti 1: Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km)” me fond limit 319,256,430.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25-06-2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDERTUESI 2014” Shpk (përfaqësues) me NIPT L46827004L dhe adresë: Shkoder, Shkoder, Rruga Daut Boriçi, zona kadastrale nr. 8594, numri i pasurisë 3/574+2-22, volumni 36, faqe 14 & “VARAKU E” Shpk me NIPT J61902509S dhe adresë: Rruga Xhafzotaj-Durrës.

Operatori ekonomik “JUBICA” SHPK me NIPT K26529001I dhe adresë: Rruga Luigj Gurakuqi, Kukle, nr. 108, Shkodër. Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar Adresa: “Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Rrugor Shqiptar me adresë: “Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjo i relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e lart monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “NDERTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Operatori ekonomik ankimues “JUBICA” SHPK ka paraqitur Formular të Paraqitjes së Argumentave pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.5. Operatori ekonomik ankimues “JUBICA” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Ndërsa bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “NDERTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk, ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së Formularit të Paraqitjes së Argumentave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik si dhe Formular Ankesë duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Ankesave pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.06.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike*”, me Nr. REF-10941-06-24-2024, me objekt “Kontrata punimesh dhe Mirëmbajtje të rrugëve nacionale (kontratat e mirëmbajtjes), Rajoni Verior Shkodër” (ndarë në 15 lote), Fondi limit i përgjithshëm / vlera e pritshme e kontratës: 2,966,127,447 (dy miliard e nëntëqind e gjashtëdhjetë gjashtë milion e njëqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e dyzet e shtatë) Lekë pa TVSH. Në Euro: 29,584,355.14 (njëzet e nëntë milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë pikë katërmbëdhjetë) Euro pa TVSH, Numri i referencës së **Lotit 1: REF-10943-06-24-2024 me objekt: “Loti 1: Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)”** (gjatësia totale 64.3 km), me vlerë totale **319,256,430** (treqind e nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tridhjetë) **Lekë pa TVSH. Në Euro: 3,184,285.16** (tre milion e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e dyqind e tetëdhjetë e pesë pikë gjashtëmbëdhjetë) **Euro pa TVSH**, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datë 25.06.2024 -29.07.2024 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit).

1. JUBICA SHPK
2. NDERTUESI 2014
3. ROZAFA 94
4. I.D.K-KONSTRUKSION

II.3. Në datën 20.08.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomik pjesëmarrës mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ku rezulton se BOE “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK, është i skualifikuar.

- | | |
|-----------------------|----------------|
| 1. JUBICA SHPK | I Kualifikuar |
| 2. NDERTUESI 2014 | I Skualifikuar |
| 3. ROZAFA 94 | I Skualifikuar |
| 4. I.D.K-KONSTRUKSION | I Skualifikuar |

II.4. Në datën 20.08.2024, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Varaku E” SHPK & “Ndërtuesi 2014” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin në fazën e parë të shprehjes së interesit, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Ndertuesi 2014 & VARAKU E” L46827004L J61902509S Skualifikohet, pasi nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 77, të LPP-së, të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit. Operatori ekonomik Ndertuesi 2014 nuk përmbush pikën 2.3.2 “...licencë profesionale vlefshme për zbatimin e kontratës, sipas kategorive të kërkuara. Në kriterin 2.3.2 është kërkuar kategoria e licencës NP-5/B, operatori ekonomik disponon kategorinë NP-5/A.

II.5. Në datën 29.08.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4505, si dhe nr. protokollit 2426/2024 datë 29.08.2024 e bashkimit i operatorëve ekonomikë “NDERTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk, ku u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimi e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDERTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i bdryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2426/2 prot., datë 29.08.2024 lidhur me arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “NDERTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk, nga procedura e prokurimit objekt-ankimi.

II.5.2. Më datë 02.09.2024, operatori ekonomik “JUBICA” SHPK ka paraqitur Formularin e paraqitjes së argumentave, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, të protokolluar pranë KKP-së, me nr. 2426/3 prot., datë 02.09.2024.

II.5.3. Në datën 03.09.2024, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës online nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDERTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk me nr. Aplikimi A/2024/4505, të paraqitur në Autoritetin Kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike” të protokolluar me tonën me nr. 2426/4 prot, datë 03.09.2024, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, në të cilën konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e **ka pranuar** ankesën e ankimuesit.

II.5.4. Me shkresën nr. 2426/5 prot., datë 04.09.2024, KPP iu drejtuar autoritetit kontraktor ARRSH, nëse është njoftuar operatori ekonomik “JUBICA” SHPK, mbi vendimmarrjen e autoritetit tuaj kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, “NDERTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk? Nëse po, ju lutem të na dërgoni kopje të librit të protokollit që vërteton njoftimin.

II.5.5. Me shkresën me nr. 4211/18 prot., datë 06.09.2024, protokolluar me tonën me nr. 2426/6 prot., datë 11.09.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP përmes shërbimit postar, “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës online nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDERTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk me nr. Aplikimi A/2024/4505, me nr. 42/11 prot., datë 06.09.2024, të protokolluar me tonën me nr. 2426/6 prot, datë 11.09.2024, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, në të cilën konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e **ka pranuar** ankesën e ankimuesit.

II.5.6. Me shkresën me datë 12.09.2024, protokolluar me tonën me nr. 2426/7 prot., datë 13.09.2024, dërguar përmes shërbimit postar, operatori ekonomik “JUBICA “ SHPK ka dërguar informacion.

II.5.7. Me shkresën përcjellëse me nr. 6477/1 prot., datë 13.09.2024, protokolluar me tonën me nr. 2426/8 prot., datë 16.09.2024, ku autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin nëpërmjet shërbimit postar, mbi njoftimin e palëve në procesi e ankimimit, duke dërguar kopje të librit të protokollit që vërteton njoftimin.

II.5.8. Me shkresën nr. 2426/9 prot., datë 18.10.2024, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor për ti kërkuar informacion mbi dokumentacionin e përllogaritjes së fondit limit të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.5.9. Me shkresën përcjellëse me nr. 7800/1 prot., datë 23.10.2024, protokolluar me tonën me nr. 2426/10 prot., datë 28.10.2024, ku autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin nëpërmjet shërbimit postar, mbi dokumentacionin e përllogaritjes së fondit limit të procedurës së prokurimit objekt ankim.

II.5.10. Referuar nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, janë paraqitur argumentet nga operatori ekonomik i interesuar “JUBICA” SHPK, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.6. Në datën 16.09.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4564, si dhe nr. 2610/2024 prot, datë 16.09.2024 i operatorit ekonomik “JUBICA” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDERTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2610/2 prot., datë 17.09.2024 lidhur me pretendime se ofertuesi BOE “Varaku E & Ndertuesi 2014” SHPK nuk përmbush kërkesat/kriteret kualifikuese, pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi.

II.6.2. Më datë 23.09.2024, BOE “Varaku E & Ndertuesi 2014” SHPK ka paraqitur Formularin e paraqitjes së argumentave, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, të protokolluar pranë KKP-së, me nr. 2610/3 prot., datë 23.09.2024.

II.7.3. Referuar nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, janë paraqitur argumentet nga BOE i interesuar “Varaku E & Ndertuesi 2014” SHPK, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Në datën 29.08.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4505, si dhe nr. protokoli 2426/2024 datë 29.08.2024 e bashkimit i operatorëve ekonomikë “NDERTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor, lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga ky bashkim operatorësh ekonomikë, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit. Më datë 02.09.2024, operatori ekonomik “JUBICA” SHPK ka paraqitur Formularin e paraqitjes së argumentave, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, të protokolluar pranë KKP-së, me nr. 2426/3 prot., datë 02.09.2024, në rolin e subjektit të interesuar, pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 03.09.2024, autoriteti kontraktor **nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave**, ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës online nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDERTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk me nr. Aplikimi A/2024/4505, të paraqitur në Autoritetin Kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike” të protokolluar me tonën me nr. 2426/4 prot, datë 03.09.2024, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të

Ankesës për trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, në të cilën konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e **ka pranuar** ankesën e ankimuesit.

Me shkresën me nr. 4211/18 prot., datë 06.09.2024, protokolluar me tonën me nr. 2426/6 prot., datë 11.09.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar në KPP **përmes shërbimit postar**, “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës online nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDERTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk me nr. Aplikimi A/2024/4505, me nr. 42/11 prot., datë 06.09.2024, të protokolluar me tonën me nr. 2426/6 prot, datë 11.09.2024, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, në të cilën konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e **ka pranuar** ankesën e ankimuesit.

Për këtë fakt, operatori ekonomik “JUBICA” SHPK, ka paraqitur Formularin e Ankesës në sistemin elektronik, pranë Komisionin e Prokurimit Publik në pëputhje me nenin 114 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, duke kundërshtuar vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA).

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në pëputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në pëputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.4. Për sa më sipër citur, bazuar në nenin 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, do të vijojë me shqyrtimin e ankesës, pasi ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar konkretisht operatori ekonomik “Jubica” SHPK, i cili ka paraqitur argumentet e tij në lidhje me ankesën, në përputhje me nenin 113 të këtij ligji, duke kundërshtuar vendimarrjen e autoritetit kontraktor, pra atë të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA).

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “JUBICA” SHPK duke kundërshtuar Vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA), mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDERTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit të sipërcituar, me argumentin se: “...kërkojmë shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave si të pa bazuar në ligj, dhe lënien në fuqi të vendimit të KVO-së duke skualifikuar bashkimin e operatorëve ekonomikë “Varaku E shpk” dhe “Ndërtuesi 2014 shpk”, pasi nuk përmbushin kriterin e dhënë në dokumentet e tenderit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 10 për pika 2.3.2. “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për zbatimin e kontratës bazuar në formatin e miratuar me VKM Nr. 42 date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhenies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licensave do të behet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa me sipër.

Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e puneve te kontrates duhet te permbaje kategorite e meposhtme:

Nr.	Licenca	Kategoria e kryerjes së punimeve
1	NP-1/A	Punime gjurmimi në tokë
2	NP-4/C	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale
3	NP-5/B	Punime nëntokësore, ura, vepra arti
4	NP-12/A	Punime inxhinierike mjedisore
5	NS-6/A	Sinjalistika rrugore jondriçuese
6	NS-7/A	Barriera dhe mbrojtja rrugore

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastruktura dhe Energji, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike qe ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- ne, Nr.42, date 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk, për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

-Akt Marrëveshje për Bashkëpunim të përkohshëm të shoqërive, e lidhur më datë 29.07.2024, midis operatorëve ekonomikë “NDËRTUESI 2014” SHPK & “VARAKU E” SHPK. Sipas Objektivit të kësaj marrëveshje është krijimi i bashkimit të përkohshëm të shoqërive me qëllimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit me **Lotit 1: REF-10943-06-24-2024 me objekt: “Loti 1: Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km), me vlerë totale 319,256,430 (treqind e nëntëmbëdhjetë milion e dyqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tridhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar. Në këtë marrëveshje janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “NDËRTUESI 2014” SHPK do të kontribuojë në masë **84 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Shoqëria “VARAKU E” SHPK do të kontribuojë në masë **16 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Shoqëria “NDËRTUESI 2014” SHPK merr**

përsipër të jetë përfaqësuese e shoqërive bashëpunuese në të gjitha procedurat e nevojshme për këtë tender.

-Licencë NZ.1192/23 e shoqërisë “VARAKU E” SHPK, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 03.04.2024;

-Licencë NZ.7061/2 e shoqërisë “NDËRTUESI 2014” SHPK, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 21.06.2024;

III.2.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të

këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

Në nenin 77 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.2.4. Neni 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

III.2.5. Në nenin 88 pika 3 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

III.2.6. VKM Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

KREU III

KATEGORIZIMI DHE KLASIFIKIMI I LICENCËS, ELEMENTET E SAJ, KUSHTET, KRITERET DHE KUFIZIMET

1. Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, garanci

a) Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas:

I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:

- profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.

II. Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente:

- Vlerën e punëve të ngjashme të kryera 4 vitet e fundit si shoqëri;
- Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë;
- Kapacitetet financiare.

b) Subjektet e licencuara në zbatim nuk mund të kualifikohen si fituese për punë publike të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik nëse janë fitues dhe/apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktor/nëkontraktor një investim sipas një kontrate të lidhur/apo në proces për t'u lidhur sipas ligjit të prokurimit publik me vlerë të përbashkët ose të veçantë që tejkalon vlerën e kategorisë që mban subjekti sipas lidhjes 4. Subjektet e licencuara kanë të drejtë të marrin pjesë/apo të shpallen fituese në prokurime publike, brenda të njëjtës periudhë deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4. Në kuptim të kësaj shkronje fjala "periudhë" kupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit të prokurimit publik nga momenti i shpalljes fitues deri në kolaudim të objektit/investimit. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoritetet kontraktore, sipas ligjit të prokurimit publik, hartojnë dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit në përputhje me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara këtu me detyrimin që kur verifikohet se subjekti përfshihet në investime që tejkalojnë klasën e kategorisë së licencuar sipas lidhjes 4, kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.

Përfundimisht bën autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila ndalohej të kualifikojë si fitues, për punë publike, të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik, të ndryshuar, kontraktorë, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nëkontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t'u lidhur, sipas ligjit të prokurimit publik, i cili nuk i ka përfunduar punimet në 70% për qind të fondit të prokuruar në autoritetin kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtatin

dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të s'kualifikohet nga pjesëmarrja ose kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme, me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.

LIDHJA 3

N.P. 5 Punime nëntokësore

Konsiderohen. Ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndëhyrjeve nëntoke që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi “goma” ose mbi “hekur”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntoksore, tunele.

LIDHJA 4

Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi

NIVELI I SHOQËRISË SIPAS VLERAVE NË LEKË TË PUNIMEVE TË KRYERA PËR ÇDO KATEGORI PUNIMI

A(edhe për herë të parë) 0- 20 milion lekë

B 21- 50 milion lekë

C 51 - 100 milion lekë

D 101 - 200 milion lekë

E 201 - 400 milion lekë

F 401 - 800 milion lekë

G mbi 800 milion lekë

III.2.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga

të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.2.8. Sa më sipër, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk, në rastin konkret kemi një bashkim operatorësh ekonomikë, të cilët kanë nënshkruar një kontratë bashkëpunimi më datë 29.07.2024. Në këtë marrëveshje janë përcaktuar nga palët edhe kontributet e tyre, ku shoqëria “NDËRTUESI 2014” SHPK do të kontribuojë në masë **84 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Shoqëria “VARAKU E” SHPK do të kontribuojë në masë **16 %** në këtë pjesëmarrje duke marrë përsipër të realizojë sipas preventivit, me indekset përkatëse, të gjitha zërat e punimeve. Shoqëria “NDËRTUESI 2014” SHPK merr përsipër të jetë përfaqësuese e shoqërive bashëpunuese në të gjitha procedurat e nevojshme për këtë tender.

Sipas preventivit të ndarjes së punimeve në këtë kontratë, Komisioni konstaton se, “NDËRTUESI 2014” SHPK ka marrë përsipër të kryejë zërat e preventivit: -Komplet kategorinë e punimeve “Mirëmbajtja rutinë”, -Komplet kategorinë e punimeve “Punimet e emergjencës”, - Tek kategoria e punimeve “Punimet e rehabilitimit periodike”, do kryejë të gjitha zërat e punimeve me përjashtim të atyre që do të kryejë shoqëria “Varaku E” SHPK të specifikuar në këtë akt marrëveshje.

Ndërsa “VARAKU E” SHPK do të kryejë punimet: -Tek kategoria e punimeve “Punimet e rehabilitimit periodike” do kryejë shtresë stabilizanti t= 10cm; shtresë stabilizanti t= 15cm; shtresë stabilizanti t= 20cm, - Komplet nënkategorinë “Ndërtim i veprave të artit + kanalizime”, Komplet nënkategorinë “Sinjalet dhe pajisjet shtesë, ngadalësueset e shpejtësisë”.

Duke iu referuar kriterit Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për zbatimin e kontratës bazuar në formatin e miratuar me VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 e ndryshuar, *punime të përgjithshme ndërtimi (NP-5B) sipas kriterit të sipërcituar*, dhe për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të provojë me dokumentacionin e kërkuar, që disponon Licencën me kategorinë e punimeve ndërtimore të përgjithshme N.P-5 dhe nivelit të kërkuar “B”. Ky kriter konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e licencës profesionale të kërkuar për ekzekutimin e kontratës. Referuar dispozitës ligjore Vendim Nr. 42, datë 16.1.2008 “*Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrojnë Veprimtari Ndërtimi*”, i ndryshuar. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i organit përgjegjës, procedurave, kriterëve për licencimin profesional për subjektet juridike që kryejnë veprimtari zbatuese ndërtimi, kategorizimi i punimeve për këto subjekte, klasifikimi i tyre, si dhe përcaktimi i të drejtave e përgjegjësisë që ka subjekti i pajisur me licencë. Licencimi, sipas kësaj rregulloreje, është i detyrueshëm për çdo subjekt juridik ose fizik vendas ose të huaj, që ushtron veprimtari ndërtimore zbatuese në Republikën e Shqipërisë pavarësisht formës së organizimit të tij. Komisioni konstaton, se anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë, “NDËRTUESI 2014” SHPK, ka ngarkuar në SPE, Licencën NZ.7061/2, e operatorit ekonomik “NDËRTUESI 2014” SHPK, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 21.06.2021. Komisioni evidentoi, se nisur nga kontrata e bashkëpunimit, rezulton se anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomikë, “NDËRTUESI 2014” SHPK ka marrë përsipër të realizojë punimet -Komplet kategorinë e punimeve “Mirëmbajtja rutinë”, -Komplet kategorinë e punimeve “Punimet e emergjencës”, - Tek kategoria e punimeve “Punimet e rehabilitimit periodike”, do kryejë të gjitha zërat e punimeve me përjashtim të atyre që do të kryejë shoqëria “Varaku E” SHPK të specifikuar në këtë akt marrëveshje, KPP konstaton, se referuar zërave të punimeve të cilat operatori ekonomik “NDËRTUESI 2014” SHPK ka marrë përsipër të kryejë, janë punimet të mirëmbajtjes rutinë, punime të emergjencës dhe pjesërisht të punimeve të rehabilitimit periodik të cilat arrijnë vlerën në total prej 20,791,028.48 lekë pa TVSH, referuar edhe procesverbalit të argumentimit të kriterëve teknike të hartuara nga autoritetit kontraktor. KPP konstaton, se referuar Vendim Nr. 42, datë 16.1.2008 i ndryshuar, *N.P. 5 Punime nëntokësore*

Konsiderohen. Ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, me anë të përdorimit të mjeteve teknike speciale, të ndëhyrjeve nëntoke që janë të lidhura me ndjeshmërinë e lëvizshmërisë mbi “goma” ose mbi “hekur”, kushdo që të jetë shkalla e rëndësisë, kompletimi i çdo veprë lidhëse, plotësime ose pajisje, në pika të veçanta ose në rrjet, rrugët hyrëse të çdo shkalle rëndësie, devijimet në nivele dhe në lartësi, punime të mureve mbajtëse. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar galeritë natyrore, shpime, kalime nëntoksore, tunele. Komisioni sqaron, se kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, ofron garanci për ekzekutimin e kontratës me sukses dhe cilësi, si dhe subjektet e licencuara kanë të drejtë të marrin pjesë/apo të shpallen fituese në prokurime publike, brenda të njëjtës periudhë deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4. Për sa sqaruar më sipër, në rastin konkret operatori ekonomik “NDËRTUESI 2014” SHPK, në licencën e dorëzuar përfshin kategorinë e N.P - 5 “*Punime nëntokësore*” por nuk përfshin nivelin “B” sipas kriterit 2.3.2 të dokumenteve të tenderit, por ka të evidentuar që përfshin kategorinë e licencës niveli “A”. Gjithashtu, referuar edhe pikës 3, të nenit 88 të VKM nr.285, më datë 19.05.2021 të Këshillit të

Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ***Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.***

Në nenin 14, të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” është parashikuar e drejta e operatorëve ekonomikë që të paraqesin oferta në procedurat e prokurimit në formën e grupeve të operatorëve ekonomikë, ndërkohë që në nenin 88 ë Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është përcaktuar detyrimi që këto grupe operatorësh ekonomikë duhet të krijohen nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi, ku të përcaktojnë qartë zërat konkret të shërbimit apo punimit apo furnizimit me mall që merr përsipër secili prej anëtarëve të këtij grupi dhe përqindjen e bashkëpunimit, si dhe kërkesat për kualifikim të natyrës ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Referuar kësaj kontrate bashkëpunimi, Shoqëria “NDËRTUESI 2014” SHPK merr përsipër të kryejë punimet në masën 84 % të punimeve totale të kontratës sipas preventivit,, si dhe aneks kontrata ku janë të pasqyruara zërat të cilët do të merren përsipër të kryhen nga secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë. Sipas preventivit të ndarjes së punimeve në këtë kontratë, Komisioni konstaton, Për kategorinë NP5 - Punime nëntokësore, ura, vepra arti, vlera e punimeve është 20,791,028.48 lekë (pa tvsh). Kjo vlerë sipas klasifikimit përkon me kategorinë B (21- 50 milion lekë).

Referuar Akt Marrëveshjes për bashkimin e përkohshëm të shoqërive të datës 29.07.2024 midis shoqërisë “NDËRTUESI 2014” shpk dhe shoqërisë “Varaku E” shpk., për realizimin e shërbimit të këtij objekti vihet re që shoqëritë do të kryejnë punimet së bashku në masën: -84 % Shoqëria “Ndërtuesi 2014” shpk -16 % Shoqëria “Varaku E” shpk Vlera e punimeve prej 20,791,028.48 lekë (pa tvsh) e përlllogaritur sipas përqindjes pjesmarrëse të secilit korespondon konkretisht me :
- Shoqëria “Ndertuesi 2014”shpk – 17,464,463 lekë (kategoria A / 0-20 milion lekë) - Shoqëria “Varaku E” shpk – 3,326,565 lekë.

Referuar VKM Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, Lidhja 4 “Klasifikimi paraprak i shoqërive ndërtimore sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi”, “Niveli I Shoqërisë Sipas Vlerave Në Lekë Të Punimeve Të Kryera Për Çdo Kategori Punimi”: A (edhe për herë të parë) 0- 20 milion lekë. Pra, në kushtet kur anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “NDËRTUESI 2014” SHPK ka marrë përsipër të kryejë zërat e preventivit: referuar akt marrëveshjes, të cilët arrijnë në total vlerën prej 17,464,463 lekë pa TVSH, ky i fundit disponon kategori licence NP-5 me nivelin “A” për këtë grup pune, pra më pak se 20 milion lekë për këtë kategori, duke qenë në përputhshmëri me VKM Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të

subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar. Pra, Komisioni konstaton, se anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “NDËRTUESI 2014” SHPK, në përputhje me zërat e preventivit të marrë përsipër për të realizuar, si dhe vlerës totale të tyre që është 17,464,463 lekë pa TVSH, ky i fundit disponon licencë NP-5 “A” për këtë grup pune, në përputhje me vlerën dhe nivelin e licencës së punimeve për këtë kategori. Për më tepër, nga preventivi, me indekset përkatëse, të përcaktuar në aktmarrëveshje, të gjitha zërat e punimeve të mbetura të kapitullit Punimet e rehabilitimit periodike, janë marrë përsipër të kryhen nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Varaku E” SHPK, i cili kryeson me 16 % si dhe disponon Licencë NZ.1192/23, regjistruar në regjistrin themeltar që nga data 03.04.2024, i cili ka licencë kategoriora NP-5 dhe niveli “C” për këtë grup pune.

III.2.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme të ngjashme me objektin e prokurimi por, edhe në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentet e tenderit. Pra, për të plotësuar pikën e mësipërme të kërkesave për kualifikim për kategorinë dhe nivelet e licencimit, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencat profesionale, pasi për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron eksperiencat e mëparshme në realizimin e këtyre kategorive punimesh por, edhe në përputhje me nivelin e përcaktuar në kriterin 2.3.2. të dokumenteve të tenderit. Sa më sipër, KPP konstaton, se me dokumentacionin e paraqitur, operatori ekonomik ankimues “NDËRTUESI 2014” SHPK arrin të vërtetojë se plotëson kriterin 2.3.2 të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “JUBICA” SHPK nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk për procedurën e prokurimit “E kufizuar, mbi kufirin e lartë monetar” me Nr. REF-10943-06-24-2024, me objekt: “Loti 1: Mirëmbajtje me performancë rruga “Han i Hotit - Tamarë, D/Grabom - Doganë, Tamarë Vermosh (Doganë)” (gjatësia totale 64.3 km)” me fond limit 319,256,430.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 25-06-2024 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “JUBICA” SHPK, për procedurën e prokurimit, objekt – ankimi.
3. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi si dhe Vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, në lidhje bashkimit të operatorëve ekonomikë “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “NDËRTUESI 2014” Shpk & “VARAKU E” Shpk.
6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “JUBICA” SHPK
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar	Anëtar	Anëtar	Anëtar
Fioorent Zguro	Anila Malaj	Kreshnik Ternova	Gjergj Mersini

Kryetar

Jonaid Myzyri

